

Platforma për të Drejtat e Njeriut

Goal: PA VARFËRI

Eliminimi i të gjitha formave të varfërisë.

Target: 1.3

Të zbatohen sistemet dhe masat e përshtatshme kombëtare të mbrojtjes sociale për të gjithë, përfshirë dhe shtresat e ulëta, dhe deri në vitin 2030 të arrihet një mbulim i konsiderueshëm i njerëzve të varfër dhe të pambrojtur.

Instrumentet ndërkombëtare

Nenet

Neni 13

Konventa për Eliminimin
e të gjitha Formave të
Diskriminimit ndaj Gruas
Konventa për Eliminimin
e të gjitha Formave të
Diskriminimit ndaj Gruas

Shtetet Palë do të marrin të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në fusha të tjera të jetës ekonomike dhe sociale, në mënyrë që të sigurojnë, mbi bazën e barazisë së burrave dhe grave, të njëjtat të drejta, në veçanti:

- (a) E drejta për përfitime familjare;
- (b) E drejta për kredi bankare, hipoteka dhe forma të tjera të kredisë financiare;
- (c) E drejta për të marrë pjesë në aktivitete rekreative, sporte dhe të gjitha aspektet e jetës kulturore.

Neni 14.2

Palët e Shteteve marrin të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në zonat rurale në mënyrë që të sigurojnë, mbi bazën e barazisë së burrave dhe grave, që ata të marrin pjesë dhe të përfitojnë nga zhvillimi rural dhe, veçanërisht, t'u sigurojnë grave të tilla e drejta:

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas
Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas

- (a) Të marrë pjesë në shtjellimin dhe zbatimin e planifikimit të zhvillimit në të gjitha nivelet;
- (b) Të ketë akses në institucione adekuate të kujdesit shëndetësor, përfshirë informacionin, këshillimin dhe shërbimet në planifikimin e familjes;
- (c) Për të përfituar drejtpërdrejt nga programet e sigurimeve shoqërore;
- (d) Të marrë të gjitha llojet e trajnimeve dhe arsimimit, formale dhe joformale, përfshirë atë që lidhet me arsimimin funksional, si dhe, ndër të tjera, përfitimin e të gjitha shërbimeve të komunitetit dhe shtrirjes, me qëllim të rritjes së aftësive të tyre teknike;
- (e) Të organizojnë grupe të vetë-ndihmës dhe kooperativa në mënyrë që të sigurojnë qasje të barabartë në mundësi ekonomike përmes punësimit ose vetë-punësimit;
- (f) Të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e komunitetit;
- (g) Të ketë qasje në kredi dhe kredi bujqësore, lehtësirat e marketingut, teknologjinë e duhur dhe trajtimin e barabartë në tokën dhe reformën agrare, si dhe në skemat e rivendosjes së tokës;
- (h) Të gëzojë kushte të përshtatshme jetese, veçanërisht në lidhje me strehimin, kanalizimet, furnizimin me energji elektrike dhe ujë, transportin dhe komunikimet.

Neni 11.2

Për të parandaluar diskriminimin ndaj gruas për shkaqe martesore ose maternitetit, dhe për të siguruar të drejtën e saj efektive për punë, shtetet palë marrin masa të përshtatshme:

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas
Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas

- (a) Për të ndaluar pushimin nga puna për shkaqe shtatzanie apo të lejes së barrës, si dhe diskriminimin në raste të pushimit nga puna të bazuar në gjendjen martesore, nën kushtet e marrjes së sanksioneve;
- (b) Për të aplikuar leje të barrës me pagesë ose për të përfituar ndihma sociale të krahasueshme, pa e humbur vendin e mëparshëm të punës, të të drejtave të vjetërsisë dhe të avantazheve sociale;
- (c) Për të inkurajuar sistemin e shërbimeve sociale mbështetëse të nevojshme që t'i mundësojnë prindërit të gërhojnë detyrimet familjare me përgjegjësitë e vendin e punës, dhe të marrin pjesë në jetën publike, sidomos duke nxitur themelimin dhe zhvillimin e një rrjeti çerdhesh e kopshtesh;
- (ç) Për të siguruar një mbrojtje të veçantë për gratë shtatzëna në ato vende të punës në të cilat provohet se puna që kryejnë është

Instrumentet ndërkombëtare

Nenet

Konventa për Eliminimin
e të gjitha Formave të
Diskriminimit ndaj Gruas
Konventa për Eliminimin
e të gjitha Formave të
Diskriminimit ndaj Gruas

Neni 11.2.c

Për të inkurajuar sistemin e shërbimeve sociale mbështetëse të nevojshme që t'i mundësojnë prindërit të gërrshetojnë detyrimet familjare me përgjegjësit në vendin e punës, dhe të marrin pjesë në jetën publike, sidomos duke nxitur themelimin dhe zhvillimin e një rrjeti

Neni 14.2.c

Konventa për Eliminimin
e të gjitha Formave të
Diskriminimit ndaj Gruas
Konventa për Eliminimin
e të gjitha Formave të
Diskriminimit ndaj Gruas

Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj gruas në zonat bujqësore me qëllim që të sigurojnë, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, pjesëmarrjen e saj në zhvillimin e fshatit dhe njëherësh në avantazhet që sjell ajo. Në mënyrë të veçantë ato i sigurojnë gruas:

(c) Të drejtën për të përfutuar drejtpërdrejt nga programet e sigurimeve sociale;

Neni 25 para 1

Deklarata Universale për
të Drejtat e Njeriut
Deklarata Universale për
të Drejtat e Njeriut

1. Gjithkush ka të drejtë për një nivel jetese të mjaftueshëm i cili t'i përgjigjet shëndetit dhe jetës së përshtatshme si të atij personalisht, ashtu edhe të familjes së tij, duke përfshirë ushqimin, veshmbathjen, banesën, kujdesin mjekësor dhe shërbimet e nevojshme sociale, si edhe të drejtën për të qenë i siguar në rast sëmundjeje, papunësie, vejanie, pleqërie dhe raste të tjera të humbjeve të mjeteve për jetesë për shkak të rrethanave të pavarura nga vullneti i tij.

Neni 19.2

19.2

Konventa për të Drejtat e
Fëmijës
Konventa për të Drejtat e
Fëmijës

Masat e tilla mbrojtëse, siç duhet, duhet të përfshijnë efektive procedurat për krijimin e programeve sociale për të siguar mbështetjen e nevojshme për fëmijën dhe për ata që kanë kujdesin e fëmijës, si dhe për format e tjera të parandalimit dhe për identifikimin, raportimin, referimin, hetimin, trajtimin dhe përcjelljen e instancave të keqtrajtimin të fëmijëve të përshkruar deri më tani, dhe, sipas rastit, për përfshirje gjyqësore.

Neni 26.1

26.1

Konventa për të Drejtat e
Fëmijës
Konventa për të Drejtat e
Fëmijës

Shtetet Palë do të njohin për çdo fëmijë të drejtën të përfitojnë nga sigurimet shoqërore, duke përfshirë sigurimet shoqërore, dhe të marrin masat e nevojshme për të arritur realizimin e plotë të kësaj të drejte, në përputhje me ligjin e tyre kombëtar.

**Instrumentet
ndërkombëtare**

Nenet

Neni 26.2

26.2

Konventa për të Drejtat e
Fëmijës
Konventa për të Drejtat e
Fëmijës

Përfitimet duhet të jepen, kur është e përshtatshme, duke marrë parasysh burimet dhe rrethanat e fëmijës dhe personave që kanë përgjegjësi për mirëmbajtjen e fëmijës, si dhe çdo konsideratë tjetër e rëndësishme për një kërkesë për përfitime të bëra nga ose në emër të fëmijë.

Neni 27.3

Konventa për të Drejtat e
Fëmijës
Konventa për të Drejtat e
Fëmijës

Shtetet Palë, në përputhje me kushtet kombëtare dhe brenda mjeteve të tyre, do të marrin masat e duhura për të ndihmuar prindërit dhe të tjerët përgjegjës për fëmijën për të zbatuar këto të drejta dhe në rast nevoje të ofrojnë ndihmë materiale dhe programe mbështetëse, veçanërisht në lidhje me ushqimin, veshjen dhe strehimin.

Ligjet

Nenet

LIGJI NR. 08/L-255
PËR SHËRBIME
SOCIALE DHE
FAMILJARE
LIGJI NR. 08/L-255
PËR SHËRBIME
SOCIALE DHE
FAMILJARE

Neni 8

8.1. Personat juridikë, që nuk janë në sektorin qeveritar, duke përfshirë ndërmarrjet, organizatat dhe shoqatat vullnetare, organizatat fetare, grupet për vetë ndihmë dhe organizatat e tjera lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare janë të inkurajuara të ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, qoftë me nismën e tyre ose me kontratë, në emër të drejtoratit komunal në rastin e shërbimeve lokale, ose në emër të Departamentit në rastin e shërbimeve në nivel të Kosovës.